



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM
PËR
POZICION TË LIRË PUNE
SEKRETAR I NËNKOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 67/2020, të Kuvendit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, pikës 6, të vendimit nr.187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpall:

- 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin Sekretar i Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Afati për dorëzimin e dokumentave: data 10.04.2022

Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

1. Asiston Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve në monitorimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të teknologjisë për identifikimin elektronik, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë.
2. Kontribuon për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve.
3. Ndjek ecurinë, zbaton detyrat e eprorit si dhe raporton ecurinë e realizimit të detyrave të ngarkuara.
4. Zbaton me përpikmëri objektivat, planifikimin dhe organizimin e punës për Nënkomisionerin.
5. Kryen dhe ushtron çdo kompetencë tjetër që i jepet nga eprori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa të përgjithshme për kandidatët

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, që nuk është shuar sipas këtij ligji.



5. Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

1. Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë, Bachelor/Master Profesional, në shkencat shoqërore.
2. Të ketë aftësi të mira komunikuese, të bashkëpunimit dhe të punës në grup.
3. Të jetë i disponueshëm të punojë jashtë orarit zyrtar të punës, në varësi të aktiviteteve.
4. Të ketë njohuri të demonstruara në fushën e komunikimit, transparencë në punë, aftësi për të punuar nën presion.
5. Të disponojë dëshmi/certifikatë dhe të flasë e të shkruajë një gjuhë të BE-së, avantazh anglisht.

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e protokollit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dokumentet e dosjes së tij personale:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje të jetëshkrimit;
3. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
4. Fotokopje e diplomës dhe listën e notave, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
5. Fotokopje e librezës së punës, nëse ka;
6. Fotokopje të kartës së identitetit;
7. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.

Lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë intervistën e strukturuar me gojë do të publikohet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KQZ-së.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në adresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.4, Tiranë, si dhe të konsultoni faqen zyrtare në internet www.kqz.gov.al.

